

Model letre për aksionarin

I dashur Aksionar:

JACO, një shoqëri JA, likuidoi asetet e saj dhe përmbylli veprimtarinë më datë 8 janar 2006. Shoqëritë JA shpërbëhen pas 12 javësh veprimtari për t'u dhënë mundësinë punonjësve të rinj të organizohen në shoqëri të reja.

Kemi kënaqësinë t'ju raportojmë që kemi arritur rezultat financiar pozitiv. Çeku bashkëlidhur me shumën prej 220 lekësh përfaqëson kthimin nga investimi fillestar prej 200 lekësh bashkë me dividendin për aksionarin. Dividenti i likuidimit përfaqëson asetet dhe fitimet, që normalisht do të mbaheshin nga shoqëritë për të financuar veprimtaritë aktuale dhe të ardhshme, nëse ato do të vazhdonin të ekzistonin.

Me krijimin e shoqërisë tonë në muajin tetor, ne vendosëm të prodhojmë dhe të shesim kafe dhe shporta me karamеле për dhurata. Ne themeluam shoqërinë, zgjodhëm një *bord drejtorësh*, zgjodhëm ekipet e departamenteve, ngritëm prodhimin dhe shitëm produktet tona. Siguruam kapitalin e shoqërisë nga shitja e 100 aksioneve me çmimin 200 lekë për aksion.

Paguam rrogat, pagat, qiranë dhe të gjitha shpenzimet tipike të një biznesi. Ekipet e departamenteve mbajtën regjistrat me të dhënat e detajuara të prodhimit, shitjeve, regjistrat financiarë dhe personalë. Shkurtimisht, realizuam të gjitha funksionet e një shoqërie të vërtetë.

Si me çdo biznes, kemi hasur disa probleme dhe jemi ndeshur me disa vendime të vështira, që në fund të fundit ofrojnë dije dhe njohuri praktike për biznesin dhe sistemin ekonomik. Mësuam rëndësinë që ka puna në ekip dhe komunikimi për të synuar suksesin e biznesit. Ne mësuam vlerën që ka kur dëgjojmë klientët dhe prodhojmë produkte të cilësisë së lartë.

Dëshirojmë t'u shprehim mirënjohjen tonë të singertë vullnetarëve tanë, Arben Shaqiri dhe Ilir Ahmeti nga instituti kërkimor "Fanari", të cilët ndanë kohën dhe njohuritë e tyre me ne. Së fundmi, dëshirojmë t'ju falënderojmë ju, aksionarët tanë, sepse pa interesin dhe angazhimin tuaj monetar në shoqërinë tonë, kjo përvojë nuk do të kishte qenë e mundur.

Sinqerisht,

Arbër Topalli

President, JACO